



VENDIM MBI PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 9 prill 2014

Numri i lëndës: 2013-25

Milorad Rajovic

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 9 prill 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin e Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 22 nëntor 2013.

II. FAKTET

2. Siç janë parashtruar nga ankuesi, faktet mund të përmbliidhen si më poshtë.

Dyshimi në përdorimin e parregullt të pronës së ankuesit

3. Ankuesi është pronar i ndërmarrjes “Udarnik Komerc SH.P.K.”, e cila ka në pronësi një pronë në Pejë.
4. Më 29 shkurt 2000 dhe përsëri më 8 korrik 2000, në përputhje me rregullat të cilat qeverisin pronën shoqërore dhe publike, Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u) ka autorizuar misionin e OSBE-së në Kosovë (OMiK) që ta merr këtë pronë duke supozuar se këto objekte ishin pronë shoqërore.
5. Më 1 mars 2000, OMiK-u ka marrë këtë pronë si pjesë të zyrave të veta rajonale në kuadër të komunës. Ankuesi deklaroi që pasi OMiK-u ka marrë këto objekte, ai menjëherë i ka njoftuar ata se objektet i takonin atij dhe se duhej bërë ndonjë marrëveshje për qiradhënie. Ankuesi pohon që gjatë kësaj periudhe dhe deri më 1 nëntor 2007, nuk ishte arritur asnjë marrëveshje për qiradhënie e as nuk ishte paguar qiraja.
6. Më 1 nëntor 2007, ndërmarrja e ankuesit ka nënshkruar një kontratë për t’ia dhënë me qira këto objekte OMiK-ut, kushtet e së cilës më pas janë respektuar. Megjithatë, ankuesi pohon se nuk kishte qenë në gjendje të hyjë në negociata me OMiK-un lidhur me zënien e objekteve gjatë periudhës 1 mars 2000 dhe 1 nëntor 2007 dhe lidhur me pagesën e qirasë për datat më të hershme që i ishin borxh ndërmarrjes.

Ankesa në Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

7. Ankuesi ka parashtruar një ankesë në Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) më 7 shtator 2009, e cila ishte regjistruar në PKDNj më 14 shtator 2009.
8. Më 31 janar 2013, PKDNj-ja ka shpallur lëndën të pranueshëm. Më 6 qershor 2013, në vendimin e tij rreth bazueshmërisë së lëndës, PKDNj-ja ka arritur në përfundim se “*edhe pse OMiK-u ka përfaqësuar shtyllë të veçantë të pranisë ndërkombëtare në Kosovë, përgjegjësia për aktivitetet e tij të përgjithshme ka mbetur mbi UNMIK-un*” ([shih par. 29 i lëndës së PKDNj-së, nr. 308/09, 6 qershor 2013](#)). PKDNj-ja më tej ka arritur në përfundim se “*zënia e objekteve në Pejë nga OMiK-u midis periudhës 1 mars 2000 dhe 1 nëntor 2007 ka penguar ankuesin që të merrej me pasurinë e tij ashtu siç ai e ka parë të arsyeshme dhe në këtë mënyrë ka përbërë ndërhyrje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj)*” ([shih par. 34 të lëndës së PKDNj-së nr. 308/09, 6 qershor 2013](#)) dhe se ka pasur shkelje të saj ([shih par. 40 prej lëndës së PKDNj-së nr. 308/09, 6 qershor 2013](#)).

9. PKDNj-ja *ndër të tjera* ka rekomanduar që UNMIK-u duhet të ndërmerr hapa të duhur ndaj OSBE-së për të ofruar dëmshpërblim për ankuesin për dëmin në para.
10. Ankuesi pohon se më 23 maj 2013 ka marrë një letër nga shefi i OMIK-ut, duke treguar se OSBE-ja ka detyrim që të paguar kompensim për shfrytëzimin e pronës. Megjithatë, prej ankuesit ishte kërkuar që edhe më tutje ta vërtetonte pronësinë mbi pronën.
11. Më 24 shtator 2013, ankuesi ka marrë një letër nga shefi i zyrës për çështje ligjore të OMIK-ut, duke vërtetuar se OSBE-ja mbetet e interesuar për të negociuar një zgjidhje përfundimtare me ankuesin. Megjithatë, është treguar se OSBE-ja nuk është në gjendje për të paguar kërkesën në shumën që është kërkuar nga ankuesi.

III. ANKESAT

12. Ankuesi në thelb kërkon nga Paneli që të zgjidhet çështja e tij, të sigurohet që OMIK-u të mbahet përgjegjës, të mundësohet qasje në gjykatat vendore dhe të ndërmjetësohet një marrëveshje e drejtë në mes të OSBE-së dhe ankuesit.

IV. LIGJI

13. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
14. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
15. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e gjyqësisë, policisë dhe doganës.
16. Paneli konstaton se ankesa e ankuesit ka të bëjë me kontestin e tij me OSBE-në në përgjithësi dhe me OMIK-un në veçanti.

17. Nuk është treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në ndonjë mënyrë në këtë çështje (krahasoni gjithashtu [Gashi kundër EULEX-it](#), 2013-20, 26 nëntor 2013, në par. 9; [U. kundër EULEX-it](#), 2013-19, 27 nëntor 2013, në par. 14-15 dhe [Susaj kundër EULEX-it](#), 2013-16, 30 gusht 2013, në par. 9-10).
18. Prandaj, kjo ankesë bie jashtë mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe si rezultat bie jashtë kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, gjen se ankesa bie jashtë kompetencave të Panelit sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese